



RAME LAHAJ
INTERNATIONAL
OPERA
FESTIVAL



**ËNDRRA
PA KUFİ
OPERA
PA MURE**



RAME LAHAJ
foundation

23.07 - 02.08.2025
Prishtina, **Kosovo**

RAME LAHAJ INTERNATIONAL OPERA FESTIVAL



Të dashur miq,

Ju mirëpresim me ngrohtësinë më të madhe në edicionin e V-të të "Rame Lahaj International Opera Festival", si festivali i vetëm që i kushtohet artit operistik në Kosovë. Këtë vit, programi i RLIOF-it shtrihet nga data 23 korrik deri më 02 gusht, përmes mbrëmjeve muzikore dhe masterklasës në zemër të kryeqytetit, në sheshet e Prishtinës. Rrugëtimi ynë nisi në vitin 2019 dhe falë mbështetjes së institucioneve, partnerëve dhe **Fondacioni Rame Lahaj**, tanimë ky rrugëtim është kthyer në një platformë për zhvillimin e artistëve të rinj e jo vetëm.

RLIOF vjen këtë vit me temën "Ëndrra pa kufi, Opera pa mure!", si një thirrje artistike për kapërcimin e sfidave, thyerjen e barrierave dhe mbi të gjitha, për fuqinë transformuese të artit në përgjithësi e atij operistik në veçanti.

Tema e këtij viti është frymëzuar nga mungesa e një shtëpie opere, e cila, në vend që të shihej si pengesë, nga RLIOF është parë si një mundësi për të ndërtuar diçka përtej asaj të prekshmes; përtej të ndjerit, përmes pasionit, përkushtimit dhe mbështetjes së publikut.

"Ëndrra pa kufi, Opera pa mure!", sjell artistë nga çdo cep i botës, duke dëshmuar se muzika është gjuhë universale e si e tillë, ajo thyen tavanet e qelqta, kufijtë administrativë e ata imagjinarë.

Në këto pesë vite, RLIOF është kthyer në një adresë prestigjioze për artistë të njohur ndërkombëtarë nga Egjipti, Afrika e Jugut, SHBA-të, Turqia, Austria, Italia, Ukraina,

Spanja e më gjerë, të cilët kanë ndarë skenën me talentët në rritje të Kosovës. Ky bashkëpunim nuk është vetëm artistik; është një deklaratë se Kosova është gati të jetë pjesë e hartës globale kulturore.

RLIOF në edicionin e pestë shpalos këtë program të veçantë:

23-25 korrik: "Nexhmije Pagarusha"

Një homazh i denjë për mbretëreshën e muzikës shqiptare, ku artistë shqiptarë dhe ndërkombëtarë risjellin kryeveprat e saja të pavdekshme.

24-29 korrik: Masterclass

29 korrik: Mbrëmja "New Generation"

Nën udhëheqjen e tenorit dhe mjeshtarit të njohur të vokalit, Ramón Vargas.

Mbrëmja "New Generation", që finalizon këtë masterklasë, do të shpalosë talentin dhe përkushtimin e pjesëmarrësve të rinj; një dëshmi e së ardhmes premtuese të muzikës operistike në Kosovë.

27 korrik: "Educating the audience of the future"

Kori dhe orkestra e fëmijëve të Prishtinës "Amadeus" do të bashkëbisedojnë me fëmijët përmes tingujve të muzikës klasike.

28 korrik: "Opera Night"

Një natë e dedikuar kryeveprave të literaturës operistike. Në këtë vit jubilar, kemi kënaqësinë të prezantojmë soprano kosovare, yllin në ngritje, Marigona Qerkezi.

30 korrik: "Ensemble Evening"

Një mbrëmje që sjell interpretimet magjistrale të Anita Rachvelishvili, e konsideruar si mezzosopranoja e kohës sonë, në një repertor të gërshetuar mes arieve lirike dhe këngëve të dashurisë.

2 gusht: Mbrëmja Gala "Rame Lahaj & Friends"

Në zemër të Prishtinës, në qiell të hapur, rikthehet mrekullia

e operës me yjet e skenës botërore: sopranoja e skenave prestigjioze Nino Machaidze, bassi italian Dario Russo, dhe padyschim, tenori ynë Rame Lahaj, me Orkestrën Simfonike të RTSH, nën udhëheqjen e mjeshtrit të madh Maestro Roberto Rizzi Brignoli.

Teksa kremtojmë këtë përvjetor të pestë, ne përsërisim thirrjen tonë me besim: "Kosova ka nevojë për një shtëpi të operës", jo për luks, por për edukim. Për brezat e rinj që duan të dëgjojnë, të mësojnë, të krijojnë. Për një të ardhme ku muzika është një shtyllë e identitetit tonë kombëtar dhe ndërkombëtar.

Derisa kjo ëndërr të bëhet realitet, ne do të vazhdojmë të krijojmë pa mure, të ëndërrojmë pa kufi, dhe të bashkojmë njerëz nga të gjitha anët përmes fuqisë së operës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e këtij rrugëtimi!

Sinqerisht,
Ekipi i RLIOF

RAME LAHAJ
INTERNATIONAL
OPERA
FESTIVAL



Dear friends,

We warmly welcome you to the 5th edition of the “Rame Lahaj International Opera Festival,” the only festival in Kosovo dedicated to the art of opera. This year, the RLIOF program spans from July 23 to August 2, bringing musical evenings and a masterclass to the heart of the capital, in the squares of Prishtina.

Our journey began in 2019 and, thanks to the support of institutions, partners, and the **Rame Lahaj Foundation**, it has now become a platform for the development of young artists and more.

RLIOF returns this year with the theme “Dreams without borders, Opera without walls!” as an artistic call to overcome challenges, break down barriers, and above all, to recognize the transformative power of art in general, and opera in particular.

This year’s theme is inspired by the absence of an opera house, which instead of being seen as an obstacle, has been embraced by RLIOF as an opportunity to build something beyond the tangible; something deeply felt through passion, dedication, and the support of the public.

“Dreams without borders, Opera without walls!” brings together artists from every corner of the world, proving that music is a universal language that breaks glass ceilings, administrative boundaries, and imaginary lines.

In these five years, RLIOF has become a prestigious destination for internationally renowned artists from Egypt,

South Africa, the USA, Turkey, Austria, Italy, Ukraine, Spain, and beyond, who have shared the stage with Kosovo's emerging talents. This collaboration is not only artistic; it is a statement that Kosovo is ready to be part of the global cultural map.

The fifth edition of RLIOF presents this special program:

July 23-25: "Nexhmije Pagarusha"

A worthy tribute to the Queen of Albanian music, where Albanian and international artists bring her immortal masterpieces back to life.

July 24-29: Masterclass

July 29: "New Generation"

Led by the renowned tenor and vocal master Ramón Vargas.

The "New Generation" evening, concluding this masterclass, will showcase the talent and dedication of the young participants, a testament to the promising future of operatic music in Kosovo.

July 27: "Educating the audience of the future"

The Prishtina children's choir and orchestra "Amadeus" will engage with children through the sounds of classical music.

July 28: "Opera Night"

A night dedicated to masterpieces of the operatic repertoire. In this jubilee year, we are pleased to present the rising Kosovo soprano star, Marigona Qerkezi.

July 30: "Ensemble Evening"

An evening featuring the masterful interpretations of Anita Rachvelishvili, considered the leading mezzo-soprano of our time, in a repertoire that blends lyricism with love songs.

August 2: Gala Night "Rame Lahaj & Friends"

In the heart of Prishtina, under the open sky, the magic of opera returns with stars of the global stage: the acclaimed soprano Nino Machaidze, Italian bass Dario Russo, and of

course, our tenor Rame Lahaj, with Symphonic Orchestra of the RTSH under the baton of the great Maestro Roberto Rizzi Brignoli.

As we celebrate this fifth anniversary, we reaffirm our call with conviction: "Kosovo needs an opera house," not for luxury, but for education. For the new generations who wish to listen, to learn, to create. For a future where music is a pillar of our national and international identity.

Until this dream becomes a reality, we will continue to create without walls, to dream without borders, and to unite people from all walks of life through the power of opera.

Thank you for being part of this journey.

Sincerely,
The RLIOF Team



RAME LAHAJ
INTERNATIONAL
OPERA
FESTIVAL

23.07 - 02.08.2025
Prishtina, Kosovo

Gala Night

Rame Lahaj & Friends

ROBERTO RIZZI BRIGNOLI

Conductor

The Symphonic Orchestra of the Radio
Television of Albania

02.08.2025 | 20:30h

"Skënderbeu" Square, Prishtina

RAME LAHAJ

Tenor

NINO MACHAIDZE

Soprano

DARIO RUSSO

Bass

Nexhmije Pagarusha

23.07.2025 | 20:30h

Open air space of National Library of Kosovo, Prishtina

24.07.2025 | 20:00h

American Retail Park - Interex, Peja

25.07.2025 | 20:00h

Main location of Interex, Mitrovica

GALA EL HADIDI
ARBËRESHË
EDONA RESHITAJ
ADHURIM GREZDA
GENT RUSHI GROUP

Masterclass

24-29.07.2025

Faculty of Arts, Prishtina

New Generation

29.07.2024 | 19:30h

Faculty of Arts, Prishtina

RAMÓN VARGAS

Vocal Coach

JESS RUCINSKI

Pianist

Educating the Audience of the Future

27.07.2025 | 13:30h

Hyperactive, Prishtina Mall

Children's Choir and
Orchestra of Prishtina
"AMADEUS"

Opera Night

28.07.2025 | 20:30h

Open air space of National Library
of Kosovo, Prishtina

MARIGONA QERKEZI

Soprano

JESS RUCINSKI

Pianist

Ensemble Evening

30.07.2024 | 20:30h

Open air space of National Library of
Kosovo, Prishtina

ANITA RACHVELISHVILI

Mezzosoprano

NIKOLOZ RACHVELI

Conductor & Pianist

RAME LAHAJ FESTIVAL ENSEMBLE



PRISHTINA

Jemi krenarë që sivjet, për të pestin vit me radhë, si edicion jubilar, Prishtina po hap zemrën e vet për Festivalin Ndërkombtar Operistik Rame Lahaj, nën moton “Ëndrra pa kufi, Opera pa mure!”.

Kam kënaqësinë që si Kryetar i Kryeqytetit shoh se si ky festival po rritet nga viti në vit, duke u shndërruar në një platformë të fuqishme të kulturës dhe të identitetit tonë.

Falë RLIOF-it, kemi mundësinë të shijojmë talentin e figurave më markante të botës së operës në zemër të Prishtinës. Suksesi i trasuar me shumë mund e angazhim nga vetë Rama, tashmë është një shteg i hapur edhe për artistët e rinj të Kosovës, drejt depërtimit në skenat më prestigjioze të botës. Ky sukses është krenari për Prishtinën dhe gjithë Kosovën.

Edhe sivjet programi artistik sjell pesë net të jashtëzakonshme muzikore, përfshirë mbrëmjen dedikuar ikonës sonë Nexhmije Pagarusha, ndërsa përmbillet me Mbrëmjen Gala “Rame Lahaj & Friends”, me yje botërore të muzikës klasike.

Përtej kufijve, bashkë!

PËRPARIM RAMA

Kryetar i Prishtinës

Patron i festivalit RLIOF



PRISHTINA

We are proud that this year, for the fifth consecutive time and as a jubilee edition, Prishtina is once again opening its heart to the Rame Lahaj International Opera Festival, under the motto "Dreams without borders, Opera without walls!"

As the Mayor of Prishtina, it is a pleasure to witness how this festival grows year after year, becoming a powerful platform for our culture and identity. Thanks to RLIOF, we have the privilege of enjoying the talent of some of the most prominent figures in the opera world, right in the heart of Prishtina. The success, paved with dedication and effort by Rame himself, has now opened a path for young Kosovar artists to break into the world's most prestigious stages. This success is a source of pride for Prishtina and all of Kosovo.

This year's artistic program once again brings five extraordinary musical nights, including an evening dedicated to our icon, Nexhmije Pagarusha, and concludes with the Gala Night "Rame Lahaj & Friends", featuring world-renowned classical music stars.

Beyond borders, together!

PËRPARIM RAMA

Prishtina Mayor

Patron of RLIOF Festival



RAME LAHAJ
INTERNATIONAL
OPERA
FESTIVAL



ËNDRRA
PA KUFİ
OPERA
PA MURE

GALA NIGHT

Rame Lahaj & Friends

Conductor: Roberto Rizzi Brignoli

The Symphonic Orchestra of the Radio
Television of Albania



**NINO
MACHAIDZE**
Soprano

**RAME
LAHAJ**
Tenor

**DARIO
RUSSO**
Bass

02.08.2025 | 20:30h

"Skënderbeu" Square



RAME LAHAJ
INTERNATIONAL
OPERA
FESTIVAL

GALA NIGHT

Rame Lahaj & Friends

The Symphonic Orchestra of the
Radio Television of Albania

Conductor: **ROBERTO RIZZI BRIGNOLI**

Soprano: **NINO MACHAIDZE**

Tenor: **RAME LAHAJ**

Bass: **DARIO RUSSO**

PROGRAM

02.08.2025 | 20:30h

"Skënderbeu" Square

Overture - **I vespri siciliani** - Giuseppe Verdi
Orchestra

O Dieu! Que de bijoux - **Faust** - Charles Gounod
Nino Machaidze

Tutto pareva sorridere - **Il Corsaro** - Giuseppe Verdi
Rame Lahaj

La calunnia è un venticello - **Il barbiere di Siviglia** -
Gioachino Rossini
Dario Russo

Měsíčku na nebi hlubokém - **Rusalka** - Antonín Dvořák
Nino Machaidze

Pourquoi me réveiller - **Werther** - Jules Massenet
Rame Lahaj

Di due figli... Abbietta zingara - **Il Trovatore** - Giuseppe Verdi
Dario Russo

Pleurez! Pleurez mes yeux! - **Le Cid** - Jules Massenet
Nino Machaidze

La danza - Gioachino Rossini
Rame Lahaj

Verranno a te sull'aure - **Lucia di Lammermoor** - Gaetano Donizetti
Nino Machaidze & Rame Lahaj

Quanto amore ed io spietata - **L'elisir d'amore** - Gaetano Donizetti
Nino Machaidze & Dario Russo



RAME LAHAJ
INTERNATIONAL
OPERA
FESTIVAL

GALA NIGHT

Rame Lahaj & Friends

The Symphonic Orchestra of the
Radio Television of Albania

Conductor: **ROBERTO RIZZI BRIGNOLI**

Soprano: **NINO MACHAIDZE**

Tenor: **RAME LAHAJ**

Bass: **DARIO RUSSO**

PROGRAM

02.08.2025 | 20:30h
"Skënderbeu" Square

Fandango - **Doña Francisquita** - Amadeo Vives
Orchestra

Les filles de Cadix - Léo Delibes
Nino Machaidze

Il canto - Romano Musumarra & Giorgio Flavio Pintus
Rame Lahaj

Për ty atdhe - Pjetër Gaci
Dario Russo

Moj e bukura more - Echoes of Arbëreshë
Angela Dell'Aquila

Medley

Nino Machaidze
Dario Russo
Rame Lahaj



ROBERTO RIZZI BRIGNOLI Dirigjent / Conductor

Roberto Rizzi Brignoli është drejtor muzikor (GMD) i Teatro Municipal de Santiago de Chile dhe Orkestrës Filharmonike të Santiagos. Nga sezoni 2023/24, ai gjithashtu shërben si GMD i Nationaltheater Mannheim.

Pas përfundimit me nderime të studimeve për piano në Conservatorio G. Verdi në Milano, ai studioi kompozim dhe dirigjim orkestre. Ai shërbeu si Shef i Shërbimeve Muzikore në Teatro alla Scala, duke bashkëpunuar ngushtë me Riccardo Mutin dhe duke drejtuar produksione si *Otello*, *La traviata*, *Rigoletto* dhe *Lucrezia Borgia* - kjo e fundit duke e bërë që emri i tij të lakohet në arenën ndërkombëtare në vitin 1997-98.

I njohur për ekspertizën e tij në operën italiane dhe franceze, ai ka drejtuar performanca në skena prestigjioze, përfshirë Deutsche Oper Berlin, Dresden Semperoper, Bolshoi Theatre, Teatro Real de Madrid, Opéra de Marseille dhe festivale të mëdha si Rossini Opera Festival dhe Sferisterio Opera Festival. Debutimi i tij në vitin 2010 në Metropolitan Opera me *La bohème* mori vlerësime të shkëlqyera nga kritika.

Përtej operës, Rizzi Brignoli është një dirigjent simfonik i vlerësuar, duke punuar me orkestra si: Orchestre National de France, Tokyo Philharmonic, Netherlands Radio Philharmonic dhe Göteborg Symfoniker. Projektet e tij të fundit përfshijnë *Giovanna d'Arco* e *Luisa Miller* nga Verdi dhe *Der Freischütz* të Weber.

Ai ka regjistruar për Sony dhe Warner Classics, me publikime të njohura në formatin DVD si *Adriana Lecouvreur* (La Scala) dhe *La Rondine* (Deutsche Oper Berlin).

Roberto Rizzi Brignoli is the Generalmusikdirektor (GMD) of Teatro Municipal de Santiago de Chile and the Santiago Philharmonic Orchestra. From the 2023/24 season, he also serves as GMD of Nationaltheater Mannheim.

Graduating with honors in piano from the G. Verdi Conservatory in Milan, he studied composition and conducting. He was Head of Music Services at Teatro alla Scala, collaborating closely with Riccardo Muti and conducting productions such as *Otello*, *La traviata*, *Rigoletto*, and *Lucrezia Borgia* - the latter marking his international breakthrough in 1997-98.

Renowned for his expertise in Italian and French opera, he has led performances at prestigious venues, including Deutsche Oper Berlin, Dresden Semperoper, Bolshoi Theatre, Teatro Real de Madrid, Opéra de Marseille, and major festivals such as Rossini Opera Festival and Sferisterio Opera Festival. His 2010 debut at the Metropolitan Opera with *La bohème* received critical acclaim.

Beyond opera, Rizzi Brignoli is an esteemed symphonic conductor, working with orchestras such as Orchestre National de France, Tokyo Philharmonic, Netherlands Radio Philharmonic, and Göteborg Symfoniker. His recent projects include Verdi's *Giovanna d'Arco*, *Luisa Miller*, and Weber's *Der Freischütz*.

He has recorded for Sony and Warner Classics, with notable DVD releases of *Adriana Lecouvreur* (La Scala) and *La Rondine* (Deutsche Oper Berlin).



NINO MACHAIDZE

Soprano

Nino Machaidze, e lindur në Tbilisi, Gjeorgji, është një soprano e njohur, e shquar për paraqitjet e saj në shtëpitë e mëdha operistike. E diplomuar në Accademia del Teatro alla Scala në Milano, ajo fitoi njohje ndërkombëtare me debutimin e saj në Salzburg Festspiele në vitin 2008 si Juliette në *Roméo et Juliette* së bashku me Rolando Villazón.

Që atëherë ajo ka interpretuar në teatro prestigjioz si Metropolitan Opera, Bayerische Staatsoper, Staatsoper Berlin, Gran Teatre del Liceu, Royal Opera House-Covent Garden, dhe Opéra National de Paris. Repertori i saj përfshin role kryesore nga *La bohème*, *Rigoletto*, *Thaïs*, *Otello*, *La traviata*, *Carmen*, *Les pêcheurs de perles* etj.

Pjesëmarrjet e saja të fundit përfshijnë *Le siège de Corinthe* në Pesaro, *Guillaume Tell* në Palermo, *Les contes d'Hoffmann* në Napoli, *La bohème* në Tokio, *Manon* në Paris dhe Vjenë, dhe *La traviata* nëpër Europë. Në sezonin 2023/24, ajo do të interpretojë në *Elisabetta, regina d'Inghilterra* në Palermo, *La bohème* në Monte Carlo, *Roméo et Juliette* në Berlin dhe *Faust* në Liège.

Machaidze ka bashkëpunuar me dirigjentë dhe yje të njohur të operas, duke konsoliduar statusin e saj si një nga sopranot më të shquara të ditëve të sotme.

Nino Machaidze, born in Tbilisi, Georgia, is a renowned soprano celebrated for her performances in major opera houses worldwide. A graduate of the Accademia del Teatro alla Scala in Milan, she gained international recognition with her 2008 Salzburg Festival debut as Juliette in *Roméo et Juliette* alongside Rolando Villazón.

She has since performed at prestigious venues such as the Metropolitan Opera, Bavarian State Opera, Berlin State Opera, Gran Teatre del Liceu, Royal Opera House-Covent Garden, and Opéra National de Paris. Her repertoire includes leading roles in *La bohème*, *Rigoletto*, *Thaïs*, *Otello*, *La traviata*, *Carmen* and *Les pêcheurs de perles*.

Notable engagements from recent seasons include *Le siège de Corinthe* in Pesaro, *Guillaume Tell* in Palermo, *Les contes d'Hoffmann* in Naples, *La bohème* in Tokyo, *Manon* in Paris and Vienna, and *La traviata* across Europe. In the 2023/24 season, she was set to perform in *Elisabetta, regina d'Inghilterra* in Palermo, *La bohème* in Monte Carlo, *Roméo et Juliette* in Berlin, and *Faust* in Liège.

Machaidze has collaborated with leading conductors and opera stars, solidifying her status as one of today's most accomplished sopranos.



DARIO RUSSO

Bass

Dario Russo është një bas italian i vlerësuar për zërin e tij të shkëlqyer dhe fisnik, siç e përshkruan gazeta prestigjioze La Repubblica. I specializuar në repertorin *bel canto*, ai ka interpretuar në disa nga teatrot më të rëndësishëm të operës në botë, përfshirë Teatro alla Scala në Milano, Bayerische Staatsoper në Mynih, Teatro San Carlo në Napoli, Gran Teatre del Liceu në Barcelona, Israeli Opera në Tel Aviv, Oper Köln, ROH në Muscat, dhe Concertgebouw në Amsterdam.

Russo ka bashkëpunuar me dirigjentë të njohur si Fabio Luisi, Donato Renzetti, Nello Santi, Charles Dutoit dhe Sebastian Weigle, si edhe me regjisorë skenikë si Laurent Pelly, Robert Carsen dhe Damiano Michieletto. Ndër rolet kryesore të tij përfshihen: Attila, Zaccaria në *Nabucco*, Padre Guardiano në *La forza del destino*, Sir Giorgio në *I Puritani*, Timur në *Turandot*, Banco në *Macbeth*, Ramfis në *Aida*, dhe Ferrando në *Il Trovatore*.

Përveç angazhimeve operistike, Dario Russo ka një karrierë të pasur koncertale, duke interpretuar vepra si *Requiem* të Verdi-t, Mozart-it dhe Dvořák-ut, *Stabat Mater* të Rossini-t, *Messa di Gloria* të Puccini-t dhe *Simfoninë e 9-të* të Beethoven-it.

Ndër angazhimet e tij të fundit përmenden rolet e Zaccaria në Teatro de la Maestranza në Sevilje, Sir Giorgio në Teatro Massimo Bellini në Catania dhe Ferrando në Teatro São Carlos në Lisbonë.

Dario Russo is an Italian bass praised for his outstanding and noble voice, as described by the prestigious newspaper *La Repubblica*. Specializing in the *bel canto* repertoire, he has performed in some of the most important opera houses in the world, including Teatro alla Scala in Milan, Bayerische Staatsoper in Munich, Teatro San Carlo in Naples, Gran Teatre del Liceu in Barcelona, Israeli Opera in Tel Aviv, Oper Köln, ROH in Muscat, and Concertgebouw in Amsterdam.

Russo has collaborated with renowned conductors such as Fabio Luisi, Donato Renzetti, Nello Santi, Charles Dutoit, and Sebastian Weigle, as well as with stage directors such as Laurent Pelly, Robert Carsen, and Damiano Michieletto. His major roles include: Attila, Zaccaria in *Nabucco*, Padre Guardiano in *La forza del destino*, Sir Giorgio in *I Puritani*, Timur in *Turandot*, Banco in *Macbeth*, Ramfis in *Aida*, and Ferrando in *Il Trovatore*.

In addition to his operatic engagements, Dario Russo has a rich concert career, performing works such as Verdi's, Mozart's and Dvořák's *Requiem*, Rossini's *Stabat Mater*, Puccini's *Messa di Gloria*, and Beethoven's *Symphony No. 9*.

Among his recent engagements are the roles of Zaccaria at Teatro de la Maestranza in Seville, Sir Giorgio at Teatro Massimo Bellini in Catania, and Ferrando at Teatro São Carlos in Lisbon.



PRISHTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS,
RINISË DHE SPORTIT



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËVE TË
JASHTME DHE DIASPORËS



RAME LAHAJ
INTERNATIONAL
OPERA
FESTIVAL



ĒNDRRA
PA KUFİ
OPERA
PA MURE

NEXHMIJE PAGARUSHA

GALA EL HADIDI
ARBĚRESHĚ
EDONA RESHITAJ
ADHURIM GREZDA
GENT RUSHI GROUP

23.07.2025 | 20:30h | Open air space of National Library of
Kosovo, **Prishtina**

24.07.2025 | 20:00h | American Retail Park - Interex, **Peja**

25.07.2025 | 20:00h | Main location of Interex, **Mitrovica**



RAME LAHAJ
INTERNATIONAL
OPERA
FESTIVAL

NEXHMIJE PAGARUSHA

Singer: **GALA EL HADIDI**

Singer: **ARBËRESHË**

Singer: **EDONA RESHITAJ**

Singer: **ADHURIM GREZDA**

Band: **GENT RUSHI GROUP**

23.07.2025 | 20:30h - Prishtina

24.07.2025 | 20:00h - Peja

25.07.2025 | 20:00h - Mitrovica

PROGRAM

Unë ty të kam dashtë - Edona Reshitaj

Perëndeshë e bukurisë - Adhurim Grezda

Dashuro - Arbëreshë

E dehur jam - Gala El Hadidi

Kur më del në derë - Edona Reshitaj

Vetë ke mbet - Gala El Hadidi

Kur më shkon si zog n'hava - Adhurim Grezda

O në atë fushë t'Mejdanit - Arbëreshë

Zani i tij më thërret - Edona Reshitaj

O moj bukuroshe - Adhurim Grezda

Ti mor djalë - Arbëreshë

Sytë për ty i kam të njomë - Edona Reshitaj

O dritë, sa të dua - Adhurim Grezda

E kujtoj atë takim - Gala El Hadidi

Medley



GALA EL HADIDI

Këngëtare / Singer

Gala El Hadidi, një mezzo-soprano e njohur egjiptiane, është e vlerësuar ndërkombëtarisht për interpretimin e saj të rolit të Carmen-it, duke u bërë egjiptiana e parë që e ka luajtur këtë rol ikonik në skenat botërore. Në tetor, ajo shënoi edhe një tjetër arritje historike, duke u bërë egjiptiana e parë që luan në një opera të Wagner-it, në rolin e Venusit në Tannhäuser në Gjermani. Karriera e saj profesionale nisi herët; vetëm 17 vjeçe, debutoi në skenën kryesore të Operës së Kajros ndërsa ishte ende studente në shkollën gjermane. Vetëm një vit më vonë, nënshkroi kontratë me Operën e Kajros, duke u bërë solistja më e re në historinë e kompanisë. Me një zë të përshtatshëm për rolet komplekse të tipit "femme fatale", Gala ndoqi rrugën e pjekurisë akademike dhe vokale, duke përfunduar një diplomë në Filozofi dhe një Master në Letërsi Angleze dhe Krahasuese në AUC, ku shkroi tezën novatore *Carmen debati mbi femme fatale*. U trajnuar nga emra të mëdhenj si Sobhi Bidair, Tom Krause dhe Marilyn Horne, dhe më pas fitoi një tjetër master në Interpretim Operistik nga Yale University. Nga viti 2010 deri në 2016 ishte nën kontratë me Semperoper në Dresden. Ajo ka fituar çmime në Audicionet e Këshillit Kombëtar të Operës Metropolitan, konkursin Stella Maris, dhe ishte finalistja e parë arabe në BBC Cardiff Singer of the World. Gala ka performuar në skena prestigjioze si Filarmonia e Berlinit, Royal Concertgebouw në Amsterdam dhe Kennedy Center. Repertori i saj përfshin rolet Carmen, Rosina, Hänsel dhe Cherubino. Diskografia e saj përfshin regjistrime me Deutsche Grammophon dhe Gutman Records, me vepra nga Berlioz, Mahler dhe Strauss.

Gala El Hadidi, a celebrated Egyptian mezzo-soprano, is internationally recognized for her portrayal of Carmen, becoming the first Egyptian to perform this iconic role on global stages. In October, she also became the first Egyptian to star in a Wagnerian opera, debuting as Venus in *Tannhäuser* in Germany. Her professional journey began early; at just 17, she made her debut on the main stage of the Cairo Opera House while still a student at the German school. A year later, she signed a contract with the Cairo Opera, becoming its youngest soloist. With a voice well-suited for complex femme fatale roles, Gala pursued academic and vocal maturity, earning a B.A. in Philosophy and an M.A. in English and Comparative Literature at AUC, where she wrote a pioneering thesis titled *Carmen debating the femme fatale*. She trained under renowned vocalists such as Sobhi Bidair, Tom Krause, and Marilyn Horne, and later earned a second master's degree in Opera Performance from Yale University. From 2010 to 2016, she was under contract with the Semperoper in Dresden. Her recognitions include awards from the Metropolitan Opera National Council Auditions, Stella Maris Competition, and being the first Arab finalist at BBC Cardiff Singer of the World. Gala has performed in prestigious venues including the Berlin Philharmonic, Royal Concertgebouw, and the Kennedy Center. Her repertoire includes roles such as Carmen, Rosina, Hänsel, and Cherubino. Her discography includes recordings with Deutsche Grammophon and Gutman Records, featuring works by Berlioz, Mahler, and Strauss



ARBËRESHË

Këngëtare / Singer

ARBËRESHË është një muzikante e shumëanshme dhe artiste që ndërthur në mënyrë unike traditën dhe modernen. Duke u rritur në Zvicër me rrënjë të thella shqiptare nga Kosova dhe Shqipëria, ajo ka eksploruar muzikën popullore shqiptare me një pasion të jashtëzakonshëm, duke i dhënë asaj një frymë bashkëkohore dhe emocionale.

E njohur për interpretimet e saja të ndjera dhe për aftësinë për të kombinuar instrumente tradicionale si defi dhe Shruti box me vokalin e saj të fuqishëm, ARBËRESHË ka arritur të prekë zemrat e audiencave në rajon dhe më gjerë. Muzika për të nuk është vetëm një pasion, por edhe një mjet për të eksploruar rrënjët e saj, për të lidhur kulturën shqiptare me botën dhe për të krijuar ura midis brezave dhe komuniteteve.

Në performancat e saj, ajo sjell origjinalitet dhe thellësi, duke rikrijuar këngët popullore shqiptare dhe duke u zhytur në histori të pasura kulturore dhe emocionale. Me një prani skenike magnetike dhe aftësinë për të komunikuar përmes muzikës, ARBËRESHË ia dedikon artin e saj ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Performancat e saj janë një reflektim i udhëtimit të saj personal, që shfaq identitetin kompleks të një shqiptareje të rritur në diasporë, duke e kthyer muzikën në një histori të fuqishme për rrënjët, rezistencën dhe dashurinë për artin.

Fokusi i fundit artistik: Përgatitja e një albumi që do të risjellë këngët popullore shqiptare në një format bashkëkohor dhe përgatitja për evente ndërkombëtare që promovojnë kulturën shqiptare.

A R B Ě R E S H Ě is a multifaceted musician and artist who uniquely combines tradition and modernity. Growing up in Switzerland with deep Albanian roots from Kosovo and Albania, she has explored Albanian folk music with immense passion, giving it a contemporary and emotional spirit.

Known for her sensitive interpretations and ability to combine traditional instruments such as the def and Shruti box with her powerful vocals, A R B Ě R E S H Ě has managed to touch the hearts of audiences in the region and beyond. Music for her is not only a passion, but also a means to explore her roots, to connect Albanian culture with the world and to build bridges between generations and communities.

In her performances, she brings authenticity and depth, recreating Albanian folk songs and delving into rich cultural and emotional stories. With a magnetic stage presence and the ability to communicate through music A R B Ě R E S H Ě dedicates her art to preserving and promoting Albanian cultural heritage.

Her performances are a reflection of her personal journey, showcasing the complex identity of an Albanian woman raised in the diaspora, turning music into a powerful story about roots, resistance and love for culture.

Latest artistic focus: Preparing an album that will bring back Albanian folk songs in a contemporary format and preparing for international events that promote Albanian culture.



EDONA RESHITAJ

Këngëtare / Singer

Edona Reshitaj është një artiste e njohur nga Kosova, aktore dhe këngëtare. Punon në Teatrin Kombëtar të Kosovës si pjesë e ansamblit rezident të aktorëve. Ka fituar shumë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare për performancat e saj në teatër dhe film. Së fundi, u shpërblye me çmimin "Aktorja më e mirë" në Festivalin mbarëshqiptar "Moisiu".

Muzika ka qenë pasioni i saj që nga fëmijëria, dhe në vitin 2006 filloi të krijojë grupin e saj muzikor. Synim ka qenë rikthimi i muzikës tradicionale shqiptare me versione të reja dhe stil unik, duke e bërë këtë muzikë të dëgjohet edhe nga të rinjtë. Ajo ka një tingull të veçantë që ndërthur muzikën tradicionale me jazz-in. Performon shpesh live dhe ka realizuar shumë koncerte brenda dhe jashtë vendit. Si kantautore dhe producente, ka realizuar këngë origjinale dhe ka përpunuar këngë të vjetra, përfshirë sesionin unplugged "Thesar" dhe koncertet "E Kuqja dhe e Zeza" dhe "Zonjat e Këngës".

Nëpërmjet muzikës, Reshitaj mbështet kauza dhe protesta, duke dhënë mesazhe dhe ngritur zërin për çështje sociale. Kënga më e re, "Më shumë se e bukur je", i dedikohet vajzave dhe grave, duke u inkurajuar të mos e shohin bukurinë si të vetmen mënyrë për t'u bërë të famshme, por të shfrytëzojnë potencialin për sukses në jetë. Përveç muzikës dhe aktrimit, ka punuar si kostumografe dhe moderuese ngjarjesh kulturore.

Edona Reshitaj is a well-known artist from Kosovo, actress and singer. She works at the National Theater of Kosovo as part of the resident actors' ensemble. She has won many national and international awards for her performances in theater and film. Most recently, she was awarded the "Best Actress" award at the "All-Albanian Festival "Moisiu".

She has been passionate about music since childhood, and in 2006 she began to create her own musical group. The goal has been to bring back traditional Albanian music with new versions and a unique style, making this music accessible to young people. She has a unique sound that combines traditional music with jazz. She performs live often and has held many concerts in the country and abroad. As a singer-songwriter and producer, she has performed original songs and has reworked old songs, including the unplugged session "Thesar" and the concerts "E Kuqja dhe e Zeza" and "Zonjat e Këngës".

Through music, Reshitaj supports causes and protests, delivering messages and speaking out on social issues. Her latest song, "Më shumë se e bukur je" ("You are more than beautiful") is dedicated to girls and women, encouraging them not to see beauty as the only way to become famous, but to use the potential for success in life. In addition to music and acting, she has worked as a costume designer and moderator of cultural events.



ADHURIM GREZDA

Këngëtar / Singer

